



Përshkrimi:

Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë (PEN), shpallë konkurs për trajnerë për Shkollën e Teknologjisë Informativë (Shkolla e IT-së). Kandidatët e përzgjedhur do t'i nënshtrohen një kursi intenziv tre javësh për gjuhë programuese, ku do t'i marrin njohuritë e duhura nga profesionistë të fushës. Pas përfundimit të kursit për trajnerë, kandidatët më të suksesshëm do të punësohen në cilësinë e trajnerëve për të rinj, në kuadër të Shkollës së IT-së në komunat e Gjilanit dhe Lipjanit.

Kjo shkollë organizohet në kuadër të projektit “Fuqizimi i Zërave Lokal për Zhvillim të Barabartë” (ALVED), projekt ky që financohet nga qeveria britanike përmes Fondit për Siguri, Stabilitet dhe Konfliktet (CSSF). Shkolla e IT-së synon t'i fuqizojë të rinjtë nga komunitetet e ndryshme në Kosovë me njohuri praktike dhe shkathtësi të nevojshme për tregun e punës në Kosovë apo edhe më gjerë.

Kriteret për aplikim:

- Moshë (22-38 vjeç);
- Njohja e mirë e Gjuhës Angleze (të kuptuarit dhe të lexuarit);
- Shkollimi paraprak (të ketë të përfunduar apo të jetë në përfundim të studimeve për TIK, inxhinieri softuerike, programim, etj);
- Njohje bazike e teknologjive (HTML, CSS, BOOTSTRAP, JAVASCRIPT, JQUERY);
- Njohje bazike paraprake e gjuhëve programuese PHP dhe MySQL databazë;
- Shkathtësi të komunikimit me kandidatë;
- Dëshirë dhe vullnet për të ndërtuar karrierë si mësimdhënësi (jo vetëm si programer).

Përparësi në aplikim kanë personat me:

- Përvojë në projekte të TIK;
- Aftësi apo përvojë në prezantim, mësimdhënie, apo trajnim;
- Trajnime relevante për shkathtësi apo metoda të mësimdhënies që kanë ndjekur në të kaluarën (trajnimet në mesimdhënie apo ofrim të trajnimeve kryesisht në fushën e teknologjisë);
- Kandidatët për trajnerë potencial duhet të kenë vetëbesim në interpretimin e njohurive të fituara.

Të drejtë aplikimi kanë kandidatët nga të gjitha komunat e Kosovës pavarësisht etnisë, religjionit, gjinisë apo orientimit seksual.

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet ta dërgojnë CV-në në këtë email: apliko@ngo-pen.com jo më larg se 15.10.2021. Ju lutemi që në subjekt të email-it të vendosni “*Emri_Mbiemri_Aplikim për trajner në shkollën e IT-së - ALVED*”. Kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen për të ju nënshtruar një testi pranues.